**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e pranimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Milaim Sylejmani** | **04.09.2026** | **05.09.2026** | **2026/0667** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.09.2026, OE “Feroda Commerce SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0667, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me plastike teknike” me nr. të prokurimit: "KEK-26-2129-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim ,vlera e parashikuar e kontratës:13,090.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.**
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-26-2129-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me plastikë teknike**

## ANKESË

**1. Identifikimi i ankuesit***

Feroda Commerce SH.P.K.
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

Magjistrala,Prishtine-Shkup
*(Adresa)*
Prishtinë

*(Vendi)* *(Kodi postar)* 10000

038/606080
*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

Fatos Peja
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*
ferodacommerce@hotmail.com
*(Adresa elektronike)*

03/09/2026
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

________________________________________
*(Emri i avokatit)*

________________________________________
*(Adresa e plotë)*

____________________ ____________________
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

____________________
*(Adresa elektronike)*

____________________ ____________________
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

- 09.04.2026 - Njoftimi per kontrate ne portalin elektronik, e-prokurimi.rks-gov.net
  Kriter Tenderi më i ultë i përgjegjshëm
- 23.04.2026 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

**PËRSHKRIMI II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
Furnizim me plastikë teknike
Nr. i prokurimit KEK-26-2129-1-2-1 / Nr. i brendshem KEKO -26-171-121
II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Furnizim me gjysem produket nga plastika teknike (Polietilen PE. Poliamid PA6 dhe PTFE –Teflon) për nevojat e TCB-ës

- 04.05.2026 - Hapja e tenderit
- 11.08.2026 - Njoftimi mbi vendimin e AK , Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit" ku te gjithe ofertuesit i shpallin si te pa pergjegjshem e po ashtu edhe neve OE Feroda Commerce Shpk , vlere e ofertes total **10,891.40** me Tvsh

2/15

- 17.08.2026 Të pakënaqur me vendimin e AK, në afat të rregullt kohorë parashtrojmë kërkesën për rishqyrtim pranë AK,
- 25.08.2026 Pergjigje per kerkesen per rishqyrtim nga AK, ku refuzohet kërkesa jonë për rishqyrtim si e pabazuar

Të pakënaqur me këtë vendimin po i drejtohemi OSHP-ës me këtë Ankesë

Kriteri i vlerësimit ka qenë tenderi i përgjegjshëm me **çmimin më të ulët.**

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [ ] **Jo** [x]

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

Pas vlersimit te tenderëve , AK kishte publikuar njoftimin mbi vendimn e AK-së më 11.08.2026 - Njoftimi për anulim te aktivitetit

Të pakënaqur me këtë vendim të AK-së dhe në afat të rregullt kohorë, me datë 17.08.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

Me datë 25.08.2026 AK e ka refuzuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim dhe të pakënaqur me këtë vendim ne po i drejtohemi OSHP-së me këtë Ankesë.

3/15

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

1. **AK ka shkelur Nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!**
2. **AK ka shkelur Nenin 28 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!**
3. **AK ka shkelur Nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!**
4. **AK ka shkelur Nenin 60 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

- **AK ka shkelur Nenin 7 të LPP-së ( Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi )**, parimin e trajtimit te barabart kur padrejtesishte thotë se të dhënat nuk përputhen me produktet e kërkuara , atëhere diskriminohemi si OE . AK shkel parimin e transparencës pasi është i detyruar të japë arsyet e argumentuara dhe të qarta për vlersimin teknik
  **(AK nuk jep asnjë argument profesional në lidhje me pretendimin në të cilin mbështetet , pasi që nuk i jep fare të dhënat teknike për materialin e kërukar siç janë dhënë ne dosien e tenderit, ne menyre qe te deshmoj pretendimi e tyre duke i krahasuar te dhenat teknik qe jane kerkuar me ato qe ne i kemi ofruar !)**

- **AK ka shkelur Nenin 28 të LPP-së (Specifikimet teknike )** - AK ka detyrim të vlerësojë ofertat vetëm në bazë të specifikimeve teknike të publikuara

AK në pozicioni 11 kërkon materialin me pershkrimin dhe te dhenat si ne vazhdim

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | 538035120 | Plastikë teknike-Koterm ( PE) | 35x120x2000mm | Temperaatura; T=[-40 ÷ +120]□C, Dendësia; δ=1.13g/cm³ | kg | 80 |

dhe thirret në eliminim tonë, që ne nuk kemi ofruar për poz. 11 materialin Polietilen por kemi ofruar Poliamid PA 6. Është e vërtetë që ne kemi ofruar Poliamid PA 6 sepse karakterstikat teknike që janë kërkuar e kërkojnë nje gjë të tillë, pasi që nuk ekziston Polietilen me këto karakteristika teknike siç janë dhënë në FTD "Temperatura; T=[-40 ÷ +120]°C, Dendësia; δ=1.13g/cm³ " këto janë karkterstika teknike te Poliamidit
**( Pra AK nuk e vlerson ofertën në bazë të specifikave të publikuara )**

4/15

Pretendimi i AK:

Sa i përket poz. 11 është kërkuar koterm PE (PE - polietilen) kurse e ofruar Liveni PA (PA Poliamid) (Polyamide 6G Cast) edhe pse si material është më i mirë dhe më i shtrenjtë, komisioni i ri-vlerësimit pas shfletimit të literaturës, konsultimit me ekspertët e fushës, bazuar edhe në praktikat e më hershme për vendin ku montohet ky material, konstaton se nuk mund të përdoret. (PA 6G është një plastikë inxhinierike shumë e fortë dhe e ngurtë, kurse PE është një material më i butë, fleksibil dhe me rezistencë të lartë ndaj lagështirës).Oferta e OE nuk përputhet me kërkesën e AK

Pra KEK-u thirret që është kërkuar materiali Koterm PE (PE-polietilein), madje ne pershkrimin e FTD nuk shënon fare Polietilen por vetem Koterm (PE), sidoqoftë karaktersitkat e materialit që kërkohen sipas FTD Temperatura; T=[-40 ÷ +120]°C, Dendësia; δ=1.13g/cm³ , e përcaktojnë që materiali i kërkuar është Poliamid PA 6 :

Madje e njëjta kërkesë ka qenë edhe në tenderin e kaluar të datës 29.08.2025 (KEK-25-7521-1-3-6) ,kur janë kërkuar pothuajse të njëjtat pozicone por me renditej tjetër dhe po ashtu ky pozicion në atë tender është kërkuar me përshkirm dhe karakteristika plotësishtë të njëjta.
Në vazhdim pjesa e pozicioneve nga tenderi i klauar, sa për te ilustruar se kemi të bëjmë pothuajse me kërkesë të njejtë. Këtë vetem po e japim në vazhdim që të shihet se si janë kërkaur pozicionet e njëjta si nga përshkrimi të dhënat teknike e edhe sasia, në mënyrë që të shihet se si ky pozicion-produkt ne tenderin ne fjalë që KEK-u po e prezenton tani si Polietilen, në tenderin e kaluar të njëjtin produkt me përshkrim dhe të dhëna 100% të njëjta e trajtonte si Poliamid

Në vazhdim -Pjesa nga tenderi i kaluar (poz 10, ku shihet se është i njejti përshkrim 100% me pozicionin nr.11 të kërkuar tani në tendrin në fjalë )

**Aneksi 1.** **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

| | Emertimi | Përmasat teknike | Karakteristikat Teknike | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Plastik teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ30x1000mm | Dendësia δ=0.94g/$cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/$mm^2$ | copë | 10 |
| 2 | Plastik teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ50x1000mm | Dendësia δ=0.94g/$cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/$mm^2$ | copë | 10 |
| 3 | Plastik teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ60x1000mm | Dendësia δ=0.94g/$cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/$mm^2$ | copë | 5 |
| 4 | Plastik teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ80x1000mm | Dendësia δ=0.94g/$cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/$mm^2$ | copë | 5 |
| 5 | Plastik teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ90x1000mm | Dendësia δ=0.94g/$cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/$mm^2$ | kg | 60 |
| 6 | Plastik teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ150x1000mm | Dendësia δ=0.94g/$cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/$mm^2$ | copë | 4 |
| 7 | Plastik teknike-Poliamid PE (Polietilen) | Φ80x1000mm | Temperaatura; T=[-40 + +110]°C, Dendësia; δ=1.15g/$cm^3$ | copë | 5 |
| 8 | Plastik teknike-Teflon ( PTFE) | Φ30x2000mm | Temperaatura; T=[-200 ÷ +260]°C, Dendësia; δ=2.1g/$cm^3$ | copë | 50 |
| 9 | Plastik teknike-Politerm PE (Polietilen) | 30x100x2000mm | Dendësia δ=0.94g/$cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/$mm^2$ | copë | 2 |
| 10 | Plastik teknike-Koterm ( PE) | 35x120x2000mm | Temperaatura; T=[-40 ÷ +120]°C, Dendësia; δ=1.13g/$cm^3$ | kg | 80 |
| 11 | Gërshetë për puthitje nga grafiti I expanduar I përforcuar me tel INCONEL dhe inhibitor kunder korozionit | 4x4 | Valva; p=600 bar, T=[-200 + 650] °C, V=1m/s ; pH 0-14 | kg | 10 |
| 12 | Gërshetë për puthitje nga grafiti I expanduar I përforcuar me tel INCONEL dhe inhibitor kunder korozionit | 10x10 | Valva; p=600 bar, T=[-200 + 650] °C, V=1m/s ; pH 0-14 | kg | 10 |

Po ashtu vlenë të ceket se në atë tender ky pozicion u pat konfirmu nga KEKu së fjala është per Poliamid. Në vazhdim pjesa nga tenderi i kalaur, kemi markuar vetëm poziconi për te cilin bëhët fjalë ( në atë kerkesë ishte poziconi nr.10 ndrsa në këtë të fundit është poz .nr.11 )

Në vazhdim pjesa e marrë nga dokumenti Pyetje/përgjgije

Prishtinë, 22.08.2025

**Përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara në lidhje me dosjen e tenderit**

**Furnizim me gërsheta puthitëse dhe plastikëteknike.**

**Ref. jonë / our ref. : KEKO-25-234-136**

| |
|---|
| **KEK-25-7521-136** |
| **Pyetjet/Pitanje/Question** |

**22.08.2025**

**Shqip:** *Poz 7 :* **Emertimi:** Plastik teknike-Poliamid PE (Polietilen)

**Dimensioni:** Ø80x1000mm

**Karakteristikat teknike :** Temperatura; T=[-40 ÷ +110]$^0$C, Dendësia; δ=1.15g/cm³

Verejtje: Ne pershkrim eshte dhene **Poliamid edhe PE (Polietilen)**, dy tipe te ndryshme te plastikes. Por ne baze te karakteristikave teknike duhet te jete Polaimaid PA 6,

Ju lutemi qe te konfirmoni se fjala eshte per Poliamid PA 6.

*Poz.10* **Emertimi:** Plastik teknike-Koterm ( PE)

**Dimensioni:** 35x120x2000mm

**Temperatura:** T=[-40 ÷ +120]°C, Dendësia; δ=1.13g/cm³

Verejtej: Ne pershkrime eshte dhene Koterm (PE) qe e pershkruan palstiken Polietilen, pasi qe Koterm eshte term i vjetër tregtar nga koha e ish-Jugosllavisë, sipas te dhenave teknike edhe ketu eshte fjala per Polaimid PA 6, material i njejte sikurse edhe per poz. nr 7 ,

Ju lutemi qe te konfirmoni se fjala eshte per Poliamid PA 6.

**Pra, Ju lutem konfirmoni se Pozicioni nr 7 dhe nr 10 është i njejti material Poliamid PA 6**, si dhe dendesia te jete e pranueshme prej 1.13 ÷1.15 g/cm³ pasi që fjala është per te njejtin material, por m'varesishte qysh e japin prodhues te ndryshem ne te dhenat teknike !

Përgjigjet/odgovor/answer/

**22.08.2025**

**Shqip:**

Poz 7 dhe 10 janëPA6.

Pra siç mund të shihet përshkrimi i ketij artikulli është plotësishtë identik 100% si në tenderin e kaluar ashtu edhe në tenderin në fjalë. Kësaj radhe ne nuk e kemi parë të arsyshme të shtrojme të njejtën pyetje, pasi që për ne ishte e qartë se ishte fjala për Poliamid dhe në fund te fundit materilet "platsikat teknike" shumë mirë përcaktohen në baze të të dhënave teknike se për cilin lloj të materialit është fjala .

Ështe e pamundur të ofrohet Polietilen me këto karakteristika sipas kërkesës së FDT siç po pretendon tani KEK-u, pasi që në momentin që kishim ofruar Polietilen, oferta jonë do të vlersohej si e pa përgjegjshme, sepse do te kishim karktersitika teknike të Polietilenit e jo siç jane cek në FDT e qe i perkasin Polaimidit

Aq me tepër është për te habitur fakti se si AK mbështet në këtë pretendim se është kërkuar Polietilen, pasi që sikur te kishte kërkuar Polietilen atëherë të dhënat teknike edhe të këtij pozicioni do duhej të ishin të njejta siç janë në pzoicionet tjera ku kërkohet Polietilien, pozicionet nr. 1 deri në poz nr. 6 dhe pzoicioni nr. 10 .

Në vazhdim po japim si janë pozicionet e kërkuar 1 deri në 6 dhe 10 ku kërkohet Oolietilien si dhe pozicion 11 që ka karateristika tjera me Polietilenin gjegjësisht i ka karatersitikat e Poliamidit

**Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

| | Shifra | Emertimi | Përmasat teknike | Karakteristikat Teknike | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 538040030 | Plastikë teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ30x1000mm | Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ | copë | 10 |
| 2 | 538040050 | Plastikë teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ50x1000mm | Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ | copë | 10 |
| 3 | 538020061 | Plastikë teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ60x1000mm | Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ | copë | 5 |
| 4 | 538040080 | Plastikë teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ80x1000mm | Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ | copë | 5 |
| 5 | 538040090 | Plastikë teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ90x1000mm | Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ | kg | 60 |
| 6 | 538040150 | Plastikë teknike-Politerm PE (Polietilen) | Φ150x1000mm | Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ | copë | 4 |
| 7 | 538070120 | Plastikë teknike-Poliamid PE (Polietilen) | Φ80x1000mm | Temperaatura; T=[-40 ÷ +110]□C, Dendësia; $\delta=1.15g/cm^3$ | copë | 5 |
| 8 | 538030023 | Plastikë teknike-Teflon ( PTFE) | Φ23x2000mm | Temperaatura; T=[-200 ÷ +260]□C, Dendësia; $\delta=2.1 g/cm^3$ | copë | 50 |
| 9 | 538030030 | Plastikë teknike-Teflon ( PTFE) | Φ30x2000mm | Temperaatura; T=[-200 ÷ +260]□C, Dendësia; $\delta=2.1 g/cm^3$ | copë | 50 |
| 10 | 538020030 | Plastikë teknike-Politerm PE (Polietilen) | 30x100x2000mm | Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ | copë | 2 |
| 11 | 538035120 | Plastikë teknike-Koterm ( PE) | 35x120x2000mm | Temperaatura; T=[-40 ÷ +120]□C, Dendësia; $\delta=1.13g/cm^3$ | kg | 80 |

Pra shihet qarte se ç’farë karakteristika teknike ka Polietileni i kerkuar ne pozicione 1÷6 dhe 10 “ Dendësia $\delta=0.94g/cm^3$,Moduli I elascititetit 500N/mm, Ngarkesat statike deri $3N/mm^2$ ”

Dhe

se ç’farë janë karktersitikat e kërkuara tek pozicioni nr 11.
Temperaatura; T=[-40 ÷ +120]°C, Dendësia; $\delta=1.13g/cm^3$

Nëse KEK-u do të kishte kërkuar të njëjtin material Polietilen si në pozicionet 1÷6 dhe 10, atëhër pse për pozicionin nr. 11 ka dhënë **karakteristika dukshëm të ndryshme**, karakteristika që e percaktojnë Poliamidin PA 6.

Po ashtu kjo mund të vërtetohet edhe nga poziconi nr. 7

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 538070120 | Plastikë teknike-Poliamid PE (Polietilen) | Φ80x1000mm | Temperaatura; T=[-40 ÷ +110]□C, Dendësia; $\delta=1.15g/cm^3$ | copë | 5 |

ku KEK-u në përshkirim jep edhe Poliamid edhe PE (Polietilen) që është gabim pasi që përmenden dy lloje të

Po ashtu në vazhdim do të japim deshmit të dhënat teknike të prodhuesve tjerë si dhe linqet e tyre ku mund të konkludohet fare lehtë se këto karaktersitiak teknike sipas FTD i përkasin materialit Poliamid PA6 (Poliamid PA 6G) është densiteti (ρ) që e dallon në mnyrë esencilale Polietilenin nga Poliamidi, ku per Polietilen densiteti është : 0.94 g/cm$^3$ përderisa për Poliamid PA 6 densiteti është : 1.13 deri ne 1.15 g/cm$^3$

Dëshmia 1 për PA 6 - Të dhënat janë marrë nga linku: https://cylexplastics.com/materials/pa6/

FAST DELIVERY
Best transportation route

QUALITY ASSURANCE
Production equipment, rich experience

ADEQUATE INVENTORY
Own factory, guaranteed inventory

### Basic characteristics of PA6 (polyamide 6 or nylon 6)

- Properties: translucent or opaque milky white crystalline polymer, freely colorable.

Physical properties:

- **Density:** 1.13~1.15g/cm$^3$
- **Melting point:** 215~225°C
- **Tensile strength:** >60.0Mpa
- **Elongation:** >30%
- **Flexural strength:** 90.0Mpa
- **Notched impact strength:** >5KJ/m$^2$
- **Thermoplasticity:** lightweight, tough, chemical resistant and durable, with good wear resistance, self-lubrication and solvent resistance.
- **Combustion characteristics:** yellow flame with blue background, burning plant smell.
- **Solvent experiment:** resistant to cyclohexanone and aromatic solvents.

**What are the advantages and disadvantages of PA6 (polyamide 6 or nylon 6)?**

Dëshmia 2 për PA 6 - Të dhënat janë marrë nga linku: https://www.lookpolymers.com/pdf/Zell-Metall-Engineering-Plastics-Zellamid-202-PA-6.pdf

**SONGHAN**
Plastic Technology Co., Ltd.
www.lookpolymers.com email : sales@lookpolymers.com

### Zell-Metall Engineering Plastics Zellamid 202 (PA 6)

**Category :** Polymer , Thermoplastic , Nylon , Nylon 6 , Nylon 6, Impact Grade

**Material Notes:**

Zellamid® 202 is a tough material with high resistance to abrasion and impact. It features good mechanical properties. By water absorption the excellent shock and vibration resistance is increased. Mechanical, electrical and dimensional properties are accordingly influenced by moisture absorption. These important characteristics add up to impressive cost / performance ratios. Typical applications for Zellamid® 202 are ball bearing races, friction bearings, pulleys, sheeves, gears, slipper blocks, vibration dampeners and absorbers, bowling pin setters, scrapers and many more.

Order this product through the following link:
http://www.lookpolymers.com/polymer_Zell-Metall-Engineering-Plastics-Zellamid-202-PA-6.php

| Physical Properties | Metric | English | Comments |
|---|---|---|---|
| Density | 1.13 - 1.15 g/cc | 0.0408 - 0.0415 lb/in³ | |
| Moisture Absorption at Equilibrium | 2.6 - 3.4 % | 2.6 - 3.4 % | Saturation at 50% RH; ISO 1110; DIN 53714 |
| Water Absorption at Saturation | 9.0 - 10 % | 9.0 - 10 % | 23°C; ISO 62; DIN 53495 |

| Mechanical Properties | Metric | English | Comments |
|---|---|---|---|
| Ball Indentation Hardness | 150 MPa | 21800 psi | H 358/30; ISO 2039; DIN 53456 |
| Tensile Strength at Break | 80.0 MPa | 11600 psi | ISO 527; DIN 53455 |
| Elongation at Break | 50 - 100 % | 50 - 100 % | ISO 527; DIN 53455 |
| Tensile Modulus | 3.00 GPa | 435 ksi | ISO 527; DIN 53452 |
| Izod Impact, Notched | 0.0850 J/cm | 0.159 ft-lb/in | ISO 180 Method A |
| | 0.350 J/cm @Temperature -40.0 °C | 0.656 ft-lb/in @Temperature -40.0 °F | ISO 180 Method A |

Dëshmia 3 për PA 6 - Të dhënat janë marrë nga linku:
https://www.stemplast.gr/img/downloads/Stemyamid%20PA6G%20DS_en.pdf

## Stemyamid PA6G

Polyamide 6 G cast

PA > PA 6 G

> rod - tube - sheet

STEMPLAST HATZIAVGOUSTIS
ENGINEERING PLASTICS

### Product data sheet

Revision date: 1.7.2025 - Version: 1.0

#### General properties

| | | |
|---|---|---|
| Density ρ | DIN EN ISO 1183-1 - ASTM D792 sim. - DIN 53479<br>DIN IEC 60413 / 203 | 1,15 gr/cm³ |
| Moisture absorption | | |
| saturation in air, 23 °C, 50% RH | DIN EN ISO 62 - ASTM D570 - DIN 53495 sim. | 2,50 % |
| saturation in water 23 °C | DIN EN ISO 62 - ASTM D570 - DIN 53495 sim. | 6,50 % |
| immersion in water, 50x50x3 mm, 23 °C/24h | DIN EN ISO 62 - ASTM D570 - DIN 53495 sim. | - |
| Flammability (thickness 3 / 6 mm) | UL94 | HB / HB |
| Oxygen index | ISO 4589 -1,-2 - ASTM D2863 sim. | 25 % |
| Open porosity | DIN 66133 | - |

#### Mechanical properties

| | | |
|---|---|---|
| Tensile stress at yield $\sigma^{yT}$ | DIN EN ISO 527 - ASTM D638 - DIN 53455 sim. | $80^{dry}$ / $55^{hum}$ MPa |
| Tensile strength $\sigma^{T}$ | DIN EN ISO 527 - ASTM D638 - DIN 53455 sim. | - |
| Elongation at break $\varepsilon^{br}$ | DIN EN ISO 527 - ASTM D638 - DIN 53455 sim. | > $25^{dry}$ / > $50^{hum}$ % |
| Modulus of elasticity $E^{T}$ | DIN EN ISO 527 - ASTM D638 - DIN 53455 sim. | > $3400^{dry}$ / > $1700^{hum}$ MPa |
| Stress at 20% strain σ | ISO 37 - ASTM D412 - DIN 53504-S2 | - |
| Stress at 300% strain σ | ISO 37 - ASTM D412 - DIN 53504-S2 | - |
| Tensile strength $\sigma^{T}$ | ISO 37 - ASTM D412 - DIN 53504-S2 | - |
| Elongation at break $\varepsilon^{br}$ | ISO 37 - ASTM D412 - DIN 53504-S2 | - |
| Flexural stress at yield $\sigma^{yB}$ | DIN EN ISO 178 - ASTM D790 - DIN 53452 sim. | - |
| Flexural strength $\sigma^{B}$ | DIN EN ISO 178 - ASTM D790 - DIN 53452 sim. | $110^{dry}$ / $60^{hum}$ MPa |
| Modulus of elasticity $E^{B}$ | DIN EN ISO 178 - ASTM D790 - DIN 53452 sim. | $3200^{dry}$ / $2000^{hum}$ MPa |
| Flexural strength $\sigma^{B}$ | DIN IEC 60413 / 501 | - |
| Compressive stress at 1/2/5% nominal strain $\sigma^{C}$ | DIN EN ISO 604 - ASTM D695 - DIN 53454 | 26/51/92 MPa |
| Compressive strength $\sigma^{C}$ | | |
| - | DIN EN ISO 604 - ASTM D695 - DIN 53454 | 107 MPa |
| parallel to layers | DIN EN ISO 604 - ASTM D695 - DIN 53454 | - |
| perpendicular to layers | DIN EN ISO 604 - ASTM D695 - DIN 53454 | - |
| Compressive strength $\sigma^{C}$ | DIN 51910 | - |
| Young's modulus E | DIN 51915 | - |
| Deformation | | |
| under load (13,7 N/mm², 24 h, 23 °C) | ASTM D621 | - |
| permanent (after 24 h relaxation, 23 °C) | ASTM D621 | - |
| compression set (72 h, 20 °C) | ISO 815-B - ASTM D395 sim. - DIN 53517 sim. | - |
| compression set (24 h, 70 °C) | ISO 815-B - ASTM D395 sim. - DIN 53517 sim. | - |
| Impact strength | | |
| Charpy unnotched $\alpha^{cU}$ | DIN EN ISO 179/1eU - DIN 53453 | no break kJ/m² |
| Charpy notched $\alpha^{cN}$ | DIN EN ISO 179/1eA - ASTM D6110 sim. | > 3 kJ/m² |
| Charpy $\alpha^{N}$ 10 and $\alpha^{N}$ 15 | DIN EN ISO 179 - DIN 53453 | - |
| Charpy $\alpha^{K}$ 10 | DIN EN ISO 179 - DIN 53453 | - |
| Charpy notched $\alpha^{K}$ 15 | DIN EN ISO 179 - DIN 53453 | - |

Në përgjigjen e AK në kërkesën tonë për rishqyrtim, AK mban të njëjtin qëndrim, përsërit të njëjtin arsyetim, pretendim se është kërkuar Polietilen përderisa në kemi ofruar Poliamid.

13/15

Në vazhdim pergjigjja e AK në kërkesën tonë për rishqyrtim.

!

Pra edhe njëher, nuk qëndron pretendimi i AK-ës se për këtë pozicion është kërkuar Polietilen, pasi që siç cituam ne atë rast të dhenat teknike do te ishin te njëjta siç janë për pzoicionet 1 ÷ 6 dhe 10 që kane te bejne me Polietilen e jo sic janë dhën në pozicionin nr.11 e që kanë të bëjnë me Poliamid PA6 Në vazhdim po i japim të dhënat teknike edhe njëher sa për ilustirm se si janë tek pozicionet ku kerkohet PE –Polietilen 1÷6 dhe 10, dhe si janë tek pozicioni nr .11 që i takojnë Poliamid-it

Te dhenat teknike ku kerkohet PE –Polietilen (Poz . 1 deri 6 dhe 10 )

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a është kompani e korporatizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës
Numri i Regjistrit: 70325399 Zyra e regjistruar: Rr. Nënë Terezë Nr. 36, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës

Dendësia $\delta$=0.94g/cm³,Moduli I elascititetit 500N/mm,Ngarkesat statike deri 3N/mm²

**Dhe të dhënat teknike për pozicoin e kërkuar nr.11, që janë në përputhshmëri me Poliamid**

Temperatura; T=[-40 ÷ +120]□C,

Dendësia; $\delta$=1.13g/cm³

Pra në forme te pergjithshme:

Nuk qëndron arsyetimi i AK se është kerkuar PE-Polietilen, pasi siç edhe e sqaruam nuk mund te ofrohet Polietilen me karaktersitika teknike siç jane dhën nga AK për këtë pozicon nr.11, këto karakteristika e definojne materialin Poliamid !

Pas gjithë këtyre sqarimeve, dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se AK do ta shqyrtoj me kujdes Kërkesën për Rishqyrtim të Vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të **bazuar** duke marrë:**V E N D I M APROVOHET** si **e bazuar** Kërkesa për Rishqyrtim e OE " **Feroda CommerceSH.P.K**" lidhur me tenderin "Furnizim me plastikë teknike" i iniciuar ngn **Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.**. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK- Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim**.Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat ligjore adekuate të LPP-së e që sipapas kësaj do duhej që Fitues të shpallej OE " **Feroda Commerce SH.P.K si i vetmi operator që i plotëson kërkesat teknike të produkteve të kërkuara**

**Përgjigje e stafit profesional teknik te komisionit të vlerësimit** :

Komisioni e ka cekur se për pozicionin 11 si material i ofruar është në disproporcion me atë që është kërkuar (nga PE (PoliEtilen) në PA (PoliAmid)). Kështu që pretendimet ankimore të OE janë të pa bazuara

KONKLUZIONI

Nga përgjigjia e AK shihet edhe se sa e padrejtë dhe sa e pasinqertë është preteksti në të cilën ata thirren per eliminimin tonë, e lënë si mundësi që në rast të vlersimit nga ndonjë palë e tretë, pala të vihet në lajthitje sepse citojne " kemi kerkuar PE (Polietilen) por nuk i japin të dhënat teknike që vet ata i kanë kërkaur sipas FTD, sepse nësë do ti ceknin edhe të dhënat- karakteristikat teknike atëhere automatikisht do të binin në kundershtim me vetveten pasi qe siç e potencuam edhe me lartë nuk do te kishte kuptim te shkruanin është kërkaur Polietilen me këto karakteristika Temperatura; T=[-40 ÷ +120]⁰C, Dendësia; $\delta$=1.13g/cm³, pasi që këto janë karaktersitka të Polimiadit ashtu siç edhe ne i kemi ofrurar. Pra me qëllim nuk i përmendin fare karakteristikat teknike!

**Krejt këtë që e thamë mund ta permbledhime edhe në një fajli te pergjithshme, ," Ne pozicionin Nr. 11 e kemi ofruar Poliamid në baze të të dhënave teknike siç janë dhenë në FDT që i pergjigjen materialit Poliamid dhe nuk mund të thuhet siç pretendon Kek-u se është kerkuar Polietilen, perderisa karakteristikat teknike i pergjigjen materialit Poliamid !.**

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr:

14/15

**VENDIM**

